| | | |
|---|---|---|
| | **REPUBLIKA E KOSOVËS**<br>**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA**<br>**KOMUNA E SUHAREKËS**<br>**OPSTINA SUVA REKA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA** | |

Lista vendimeve dhe marrveshje të nënshkruara nga Kryetari i Komunës **Bali MUHARREMAJ – Mars 2021**

| **Nr.** | **Emri i vendimit** | **Numri i protokolit** |
|---|---|---|
| 1. | Marrveshje për Bashkfinancimin e projetit " Mirmbajtja e hapsirave të veqanta publike në Komunën e Suharekes e lidhur ne mes të Ministrisë të ekonomise dhe ambientit njësis per politika dhe monitorim të Ndërmarrjeve publike | 01-016-17337 |
| 2. | Memorandum i mirkuptimit ne mes Ministrise së Ekonomisë dhe Ambientit dhe Komunë së Suharekës per financim të projektit kapital | 01-016-17338 |
| 3. | Memorandum i mirëkuptimit për financimin e projekteve infrastrukturore në Komunën e Suharekës | 01-016-18171 |
| 4. | Vendim – Sale Bytyqi – Caktohet menaxher i kontrates "Shërbime shëndetsore për P.A.K.<br>Besa Kuqi – Caktohet mbikqyres i drejtperdrejt | 01-016-15641 |
| 5. | Vendim – Enver Shabani – Drejtor i drejtorise per sherbime publike caktohet menaxher i Kontrates" Furnizim me pako ushqimore<br>Besa Kuqi – Drejtoreshe per drejtorine e shendetsis caktohet mbikqyres i drejtperdrejt | 01-016-15642 |
| 6. | Vendim – Doruntina Bytyqi – Ingjiniere ne drejtorin e Urbanizimit caktohet menaxher i kontrates<br>Remzi Bajselmani – Drejtor i drejtorise se arsimit caktohet mbikqyres i drejtperdrejt | 01-410-17737 |
| 7. | Vendim – Berat Kabashi – Zyrtar për menaxhimin e projketeve caktohet menaxher i Kontrates " Rregullimi i rruges Brigada 123 Qender – Suhareke Doruntina Bytyqi - Ingjiniere ne drejtorin e Urbanizimit caktohet mbikqyres i drejtperdrejt | 01-410-17737 |
| 8. | Vendim – Besa Kuqi – Drejtoreshe e DSHMS caktohet menaxher i "Marrveshjes së Mirkuptimit për financim" ne mes komunes se suharekes dhe bashkesis islame ne suhareke | 01-016-18844 |
| 9. | Vendim – Besa Kuqi – Drejtoreshe e DSHMS caktohet menaxher i : Marrveshjes së Mirëkuptimit për financim në mes të Komunës së Suharekes dhe Priftit të Bashkësis Katolike për kryrjen e riteve fetare dhe mbulimi i shpenzimeve te varrimit per qytetaret e Komunes se Suharekes perkatesis fetare Katolike | 01-016-18848 |
| 10. | Vendim – Besart Gashi – Zyrtar në DA caktohet menaxher i kontrates " Shërbimet e parkingut per automjete zyrtare komunale" Donjeta Kololli – Zyrtare në DA caktohet mbikqyres i drejtperdrejt | 01-016-18939 |
| 11. | Vendim – Formohet komisioni për vlersim të ofertës " Ndërtimi i rrugeve lokale në Maqitevë" | 01-410-20713 |
| 12. | Aktvendim për hapje të ofertës "" Ndërtimi i rrugeve lokale në Maqitevë" | 01-410-20715 |

| | | |
|---|---|---|
| 13. | Vendim – Formohet komisioni për vlersim të ofertës " Ndërtimi i rrugës në Sallagrazhdë" | 01-410-20354 |
| 14. | Aktvendim për hapje të ofertës " Ndërtimi i rrugës në Sallagrazhdë" | 01-410-20356 |
| 15. | Vendim – Formohet komisioni për vlersim të ofertës " Ndërtimi i rruges dibra – Vazhdim Dvoran" | 01-410-20011 |
| 16. | Aktvendim për hapje të ofertës "" Ndërtimi i rruges dibra – Vazhdim Dvoran" | 01-410-20012 |
| 17. | Vendim – Formohet komisioni për vlersim të ofertës " Ndërtimi i rrugës në Mushtishtë" | 01-410-20365 |
| 18. | Aktvendim për hapje të ofertës " Ndërtimi i rrugës në Mushtishtë" | 01-410-20360 |
| 19. | Aktvendim për hapje të ofertës " Rregullimi i rrugëve – Vazhdim Dubravë" | 01-410-17980 |
| 20. | Vendim – Formohet komisioni për vlersim të ofertës " Renovimi i tualeteve dhe gelqerosja e objektit të QPS dhe DSHMS" | 01-410-19449 |
| 21. | Aktvendim për hapje të ofertës "" Renovimi i tualeteve dhe gelqerosja e objektit të QPS dhe DSHMS" | 01-410-19451 |
| 22. | Vendim – Formohet komisioni për vlersim të ofertës " Shërbimet e parkingut për automjetet e zyrtareve komunal " | 01-016-15932 |
| 23. | Vendim – Formohet komisioni për rivlersim te ofertës " Renovimi dhe Mirëmbajtja e lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve – Faza e tretë - Përfundimtare | 01-410-17724 |
| 24. | Vendim – Formohet komisioni për vlersim te ofertes " Ndërtimi i infrastrukturës për Bujqësi dhe Pylltari – Hapja e rrugëve fushore" | 01-410-17750 |
| 25. | Aktvendim për hapje të ofertës "" Ndërtimi i infrastrukturës për Bujqësi dhe Pylltari – Hapja e rrugëve fushore" | 01-410-17751 |
| 26. | Vendim – Formohet komisioni për vlersim te ofertes " Furnizim me oksigjen medicional për QKMF – Suharekë" | 01-016-14429 |
| 27. | Aktvendim për hapje të ofertës "" Furnizim me oksigjen medicional për QKMF -Suharekë" | 01-410-14420 |
| 28. | Vendim – Formohet komisioni për vlersim te ofertes " Ndërtimi i rrugëve lokale në Budakovë" | 01-410-20716 |
| 29. | Aktvendim për hapje të ofertës "" Ndërtimi i rrugëve lokale në Budakovë" | 01-410-20718 |
| 30. | Vendim – Formohet komisioni për vlersim të ofertës " Ndërtimi i rrugëve në Bukosh" | 01-410-17745 |
| 31. | Aktvendim për hapje të ofertës "" Ndërtimi i rrugëve në Bukosh" | 01-410-17746 |
| 32. | Vendim – Formohet komisioni për vlersim të ofertës " Ndërtimi i rrugëve lokale në Gjinoc " | 01-410-20351 |
| 33. | Aktvendim për hapje të ofertës " Ndërtimi i rrugëve lokale në Gjinoc " | 01-410-20353 |
| 34. | Vendim – Formohet komisioni për vlersim të ofertës " Furnizim me mobilje – Inventar për shkolla – Paisje të kuzhinës per qerdhen e fëmijeve Flutura në Sopijë dhe Gjinoc." | 01-410-20009 |
| 35. | Aktvendim për hapje të ofertës " Furnizim me mobilje – Inventar për shkolla – Paisje të kuzhinës per qerdhen e fëmijeve Flutura në Sopijë dhe Gjinoc." | 01-410-20010 |

| | | |
|---|---|---|
| 36. | Vendim – Formohet komisioni për vlersim të ofertës “ Rregullimi dhe ndërtimi i shtallave për bageti – Furnizim me material ndërtimor” | 01-410-19452 |
| 37. | Aktvendim për hapje të ofertës ““ Rregullimi dhe ndërtimi i shtallave për bageti – Furnizim me material ndërtimor” | 01-410-19453 |
| 38. | Vendim – Formohet komisioni për vlersim të ofertës “ Furnizim me Barëra” | 01-410-20007 |
| 39. | Aktvendim per hapje te ofertes “Furnizim me Barëra” | 01-410-20008 |
| 40. | Aktvendim per hapje te ofertes “ Ndërtimi i rrugëve Grejkoc” | 01-410-16209 |
| 41. | Vendim – Formohet komisioni per vlersim te ofertës “ Ndërtimi i rrugëve Nishor “ | 01-410-15514 |
| 42. | Aktvendim per hapje te ofertes “Ndërtimi i rrugëve Nishor “ | 01-410-15511 |
| 43. | Vendim – Formohet komisioni per vlersim te ofertës “ Rregullimi i rrugës – Pune shtesë” | 01-016-14423 |
| 44. | Aktvendim – Formohet komisioni per hapje të ofertes “ Ndërtimi i rrugeve lokale Gelancë” | 01-410-16941 |
| 45. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Ndërtimi i rrugeve lokale –Varrezave Grejkoc” | 01-410-16209 |
| 46. | Aktvendim per hapje te ofertes “ Rregullimi i rruges vazhdim ne Studenqan” | 01-410-16711 |
| 47. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Ndërtimi i rrugeve lokale Gelancë” | 01-410-16941 |
| 48. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Ndërtimi i rrugeve lokale në Samadraxhë” | 01-410-17748 |
| 49. | Aktvendim per hapje te ofertes “ Ndërtimi i rrugeve lokale në Samadraxhë” | 01-410-17749 |
| 50. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Ndërtimi i rrugeve lokale në Semetisht “ | 01-410-16938 |
| 51. | Aktvendim per hapje te ofertes ““ Ndërtimi i rrugeve lokale në Semetisht “ | 01-410-16938 |
| 52. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Ndertimi i rrugeve lokale Reshtan” | 01-410-16220 |
| 53. | Aktvendim per hapje te ofertes ““ Ndertimi i rrugeve lokale Reshtan” | 01-410-16220 |
| 54. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Rregullimi i rruges vazhdim në Studenqan “ | 01-410-16771 |
| 55. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “Krijimi i hapsirave gjelbruese në Komunë” | 01-410-19904 |
| 66. | Aktvendim per hapje te ofertes ““Krijimi i hapsirave gjelbruese në Komunë” | 01-410-19005 |
| 57. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Rregullimi dhe sanimi i rrugeve lokale në Komunë” | 01-410-19699 |
| 58. | Aktvendim per hapje te ofertes ““ Rregullimi dhe sanimi i rrugeve lokale në Komunë” | 01-410-19702 |
| 59. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Sigurimi i automjeteve zyrtare” | 01-410-19001 |
| 60. | Aktvendim per hapje te ofertes “ Sigurimi i automjeteve zyrtare” | 01-410-19003 |
| 61. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Fondi Emergjent “ | 01-410-19698 |

| | | |
|---|---|---|
| 62. | Aktvendim per hapje te ofertes “ Fondi Emergjent” | 01-410-19700 |
| 63. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Ndërtimi i rrugeve lokale në Bllacë” | 01-016-17975 |
| 64. | Aktvendim per hapje te ofertes “ Ndërtimi i rrugeve lokale në Bllacë” | 01-410-17977 |
| 65. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Ndërtimi i rrugeve në Neperbishtë” | 01-410-18221 |
| 66. | Aktvendim per hapje te ofertes “ Ndërtimi i rrugeve në Neperbishtë” | 01-410-18223 |
| 67. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Rregullimi i rrugeve lokale në Duhël” | 01-410-18215 |
| 68. | Aktvendim per hapje te ofertes ““ Rregullimi i rrugeve lokale në Duhël” | 01-410-18218 |
| 69. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Rregullimi i rrugeve lokale në Sllapuzhan “ | 01-410-18390 |
| 70. | Aktvendim per hapje te ofertes “ Rregullimi i rrugeve lokale në Sllapuzhan “ | 01-410-18388 |
| 71. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Ndërtimi i rrugëve në Doberdelan” | 01-410-18214 |
| 72. | Aktvendim per hapje te ofertes “ Ndërtimi i rrugëve në Doberdelan” | 01-410-18216 |
| 73. | Vendim - Formohet komisioni per vlersim te ofertes “ Ndertimi i rrugeve lokale ne Terrnje – Vazhdim Lot 2” | 01-410-16710 |

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISE DHE AMBIENTIT
MINISTARSTVO EKONOMIJE I ZIVOTNE SREDINE
MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
01 745
6 19.03.21
PRISHTINE A NO.1

12.03.2021

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA
REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKË
01 016 17387 7

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
**Qeveria – Vlada - Government**

**Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**
**Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine/Ministry of Economy and Environment**

---

## MARRËVESHJE PËR BASHKFINANCIMIN E PROJEKTIT "MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË VEÇANTA PUBLIKE NË KOMUNËN E SUHAREKËS"

**E lidhur në mes të**

**MINISTRISË TË EKONOMISË DHE AMBIENTIT**
**NJËSISË PËR POLITIKA DHE MONITORIM TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE**

**KOMUNA E SUHAREKËS**

**DHE**

**KRM "EKOREGJIONI" SH.A**

Mbështetur në nenin 10 të Ligji Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare/ Nr.7/01 mars 2019), neni 8 paragrafi 1.4 të Rregullores (QRK) - Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Shtojca 9 e Rregullores (QRK) - Nr.07/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, neni 5 i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, Ligji Nr.03/L-048 Për Menaxhim të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligji Nr. 05/L -007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i ndryshuar dhe plotësuar, Ligji Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe ndryshim plotësimet e tij, palët nënshkruese pajtohen të lidhin këtë:

## MARRËVESHJE PËR BASHKFINANCIMIN E PROJEKTIT
"Mirëmbajtja e hapësirave të veçanta publike në Komunën e Suharekës"

### Neni 1
### Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është mbështetja financiare nga palët nënshkruese për realizimin e projektit "Mirëmbajtja e hapësirave të veçanta publike në Komunën e Suharekës". Ky projekt përfshin mirëmbajtjen, vendosjen e pajisjeve të mbeturinave sipas standardeve, vendosjen e kushteve për mirëmbajtje të rregullt dhe funksionale të hapësirave të veçanta publike në këtë komunë.

### Neni 2
### Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit

1. Për realizimin e projektit "Mirëmbajtja e hapësirave të veçanta publike në Komunën e Suharekës", palët nënshkruese do të financojnë:

1.1. MEA në vitin fiskal 2021, do të financojë projektin nga kodi 10/213/22500/30/18878/0630 nga programi uji dhe hedhurina në vlerë prej 100,000.00 (njëqind mijë) euro.

1.2. Komuna e Suharekës do të financojë projektin për vitin 2021 në vlerë prej 20,000.00 (njëzet mijë) euro.

1.3. KRM "Ekoregjioni sh.a", Prizren, do të financojë projektin për vitin 2021 në vlerë prej 10,000.00 (dhjetë mijë) euro.

Neni 3
Detyrimet e Palëve

1. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit pagesat për bashkëfinancimin e projektit "Mirëmbajtja e hapësirave të veçanta publike në Komunën e Suharekës" do t'i bëjë sipas kërkesës së KRM "Eko regjioni sh.a", Prizren, konfrom nenit 6 të kësaj marrëveshje.

1.1. MEA, për projektin kapital transferon mjetet në llogarinë e KRM Ekoregjioni sh.a Prizren me numër të llogarisë bankare: **13-01-0015000186.11 në BPB Banke**.

2. Komuna e Suharekës obligohet që t'i krijojë kushtet e nevojshme për realizimin e projekti "Mirëmbajtja e hapësirave të veçanta publike në Komunën e Suharekës" për operatorin ekonomik, dhe të ndërmarrë të gjitha masat që kontraktuesi pa pengesë të fillojë implementimin e projektit me kohë.

3. KRM "Ekoregjioni sh.a", Prizren, obligohet të marrë të gjitha masat që shuma e buxhetit për projektin "Mirëmbajtja e hapësirave të veçanta publike në Komunën e Suharekës" sipas nenit 2 të realizohet gjatë vitit 2021.

4. KRM "Ekoregjioni sh.a", Prizren, obligohet që projekti "Mirëmbajtja e hapësirave të veçanta publike në Komunën e Suharekës" të realizohet në pajtim me Ligjin Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, Ligji Nr.03/L-048 Për Menaxhim të Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe plotësim ndryshimet e tij.

Neni 4
Menaxhimi i llogarisë bankare

KRM "Ekoregjioni sh.a" Prizren duhet të mbajë llogari bankare të veçantë për projektin kapital, "Mirëmbajtja e hapësirave të veçanta publike në Komunën e Suharekës" dhe nuk mund të përzihet me fondet e tjera.

Neni 5
Zhvillimi i Buxhetit dhe Planet e Prokurimit

1. KRM "Ekoregjioni sh.a" Prizren, do të krijojë dhe të mbajë të azhurnuara dhe të ofrojë te MEA/NJPMNP sipas kërkesës brenda vitit 2021 dokumentet lidhur me kontratat e nënshkruara gjatë vitit 2021 si në vijim:

   1.1. Njoftimi për Shpallje ne KRPP (kopje fizike);

   1.2. Kopjen e Procesverbalit të hapjes së ofertave për projekt;

   1.3. Kopjen e Procesverbalit të vlerësimit të ofertave për projekt;

   1.4. Kontratën me fituesin e tenderit për projekt gjegjësisht Operatorin Ekonomik;

   1.5. Çdo lloj materiali tjetër i kërkuar prej Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë ose Ligjit të Prokurimit.

## Neni 6
## Transferimi i Mjeteve financiare për Projekte Kapitale

Kërkesës për transferimin e mjeteve për projekte kapitale lidhur me nenin 2 të kësaj Marrëveshje, KRM Ekoregjioni sh.a Prizren, duhet bashkangjitur dokumentet si vijon:

1.1. Njoftimi për Shpallje ne KRPP (kopje fizike);

1.2. Vendimin e KE për formimin e Komisionit për hapje të ofertave;

1.3. Kopjen e Procesverbalit të hapjes së ofertave për projekt;

1.4. Vendimin e KE për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave;

1.5. Kopjen e Procesverbalit të vlerësimit të ofertave për projekt;

1.6. Kontratën me fituesin e tenderit për projekt/Operatorin Ekonomik;

1.7. Faturën mbi kryerjen e punëve apo furnizimeve nga projekti;

1.8. Raportin e Komisionit profesional mbi pranimin e punës apo furnizimeve nga faturat e paraqitura për pagesa;

1.9. Raportin e auditorit të Brendshëm ose Opinionin e Komisionit të Auditimit mbi rregullsinë e implementimit të projektit për periudhën para bërjes së kërkesës nga KRM Ekoregjioni sh.a Prizren

## Neni 7
## Raportimi

1. KRM "Ekoregjioni sh.a" Prizren obligohet të paraqes te NJPMNP/MEA, raportin tremujor dhe vjetor mbi mbarëvajtjen e projektit dhe shfrytëzimin e mjeteve, duke përfshirë shpenzimet e tërhequra, përpara ditës së 15-të të punës duke filluar numërimin që nga dita e plotësimit të tremujorit të kaluar. Raporti tremujor dhe vjetor duhet të përmbajë detajet e progresit të arritur për projektin kapitale të financuara nga buxheti i Kosovës (përshkrimi në cilën fazë gjendet projekti).

2. Nëse paraqitet kërkesa për raporte shtesë nga NJPMNP/MEA dhe Komuna e Suharekës, KRM "Ekoregjioni sh.a"- Prizren, do të pajisë palët me të dhënat e kërkuara.

3. KRM "Ekoregjioni sh.a" Prizren do të njoftoj palët për rastet e mëposhtme që mund të ndodhin:

   3.1. Në rast kur "KRM Ekoregjioni sh.a", Prizren, bëhet subjekt i një hetimi nga një rregullator duke përfshirë por pa kufizuar Njësinë e Hetimit Financiar, Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, Kontrollin Financiar nga ZKA, Autoritetet e Taksave;

3.2. Kur ka një kërkesë në gjykatë në lidhje me prokurimin, kontratën, shpenzimet, ose Subvencionin;

3.3. Kur ka një dyshim në keqpërdorim material ose shkelje të rregullave të prokurimit në lidhje me fondet e Buxhetit të Republikës së Kosovës apo fondet e tjera nga operatori ekonomik;

Neni 8
Udhëzimet e MEA-së

Në lidhje me përdorimin e çdo pjese të mjeteve financiare, KRM "Ekoregjioni sh.a"- Prizren, duhet të pajtohet që të ndjekë udhëzimet apo instruksionet e vendosura prej MEA/NJPMNP dhe të përdorë çdo model të dokumenteve të rekomanduara prej kësaj Njësie, duke ditur që këto udhëzime, instruksione, apo modele janë në përputhje me ligjet në fuqi.

Neni 9
Zbatimi

Kjo marrëveshje nuk mund të zbatohet, ose të krijojë të drejta për një palë të treta, pa marrë parasysh rrethanat në të cilat mund t'a detyrojnë KRM "Ekoregjioni sh.a"- Prizren në kufizimin e shfrytëzimit të buxhetit të ndarë me këtë marrëveshje.

Neni 10
Mbikëqyrja
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit/NPMNP dhe Komuna e Suharekës, janë përgjegjëse për mbikëqyrjen në realizimin e kësaj marrëveshje.

Neni 11
Mosmarrëveshjet

1. Mosmarrëveshjet eventuale mes Palëve do të zgjidhen me mirëkuptim të ndërsjellë.

2. Në rast se palët nuk arrijnë t'i zgjidhin me mirëkuptim të ndërsjellë, palët mund t'i drejtohen gjykatës kompetente në Prishtinë.

Neni 12
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshje, shfuqizohet Marrëveshja (trepalëshe) Bashkëpunimi Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit ,Komunës së Suharekës dhe KRM "Ekoregjioni "sh.a me Nr. Prot.01/65 e datës 13.01.2021.

Neni 13
Vlefshmëria

Kjo marrëveshje është e vlefshme nga dita e nënshkrimit deri më 31.12.2021.

Neni 14

Hyrja në Fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në emër të:

| | |
|---|---|
| **Muharrem Nitaj**<br>**Ministër** | **Bali Muharremaj**<br>**Kryetar i Komunës së Suharekës** |
| **NJPMNP**<br>**DREJTORI** | **KRM Ekoregjioni Sh.A**<br>**DREJTORI** |

**Prishtinë, 19.03 2021**

17.03.2021

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA
REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

MARRË NË DORËZIM - PRIMLJENO - RECEIVED

| Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit | Numri Broj Number | Shtojca Prilog Appendix | Vlera Vrednost Value |
|---|---|---|---|
| 01 | 016 | 18171 | 2 |

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION

Njësia org. / Org. Jedinica / Org. Unit: 02 — Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 2301
Nr. i Faqeve / Br. Stranica / No. Pages: 04 — Data / Datum / Date: 18.03.21
PRISHTINË/A

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***
*Ministria Infrastrukturës*
*Ministarstvo Infrastrukture*
*Ministry of Infrastructure*

Prishtinë, 11.03.2021

**MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE INFRASTRUKTURORE NË KOMUNËN E SUHAREKËS**

**Neni 1**
**Palët Nënshkruese**

1. **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS**, e përfaqësuar nga Ministri i MI-së, (në tekstin e mëtejmë MI),

dhe

2. **KOMUNA E SUHAREKËS**, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejmë Komuna).

**Neni 2**
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi është financimi i projekteve infrastrukturore të cekura më poshtë si dhe përcaktimi i obligimeve të MI-së dhe Komunës për realizimin e projekteve:

1. **Ndërtimi i rrugës Baçevc- Sallagrazhdë-Grejkoc-Korishë, Suharekë**, kodi i projektit nr.18889 në vlerë prej **400,000 €**, Ndarjet buxhetore për vitin 2021 janë 50,000 €, ndërsa për vitet në vijim mjetet buxhetore të parashikuara janë **350,000 €**;

2. **Ndërtimi i rrugës Gjinoc-Novakë-Mamushë**, kodi i projektit nr.10041, në vlerë prej **398,200 €**;
   Ministria e Infrastrukturës e financon projektin me 350,000 €, ndarjet buxhetore për vitin 2021 janë 100,000 €, ndërsa për vitet në vijim mjetet buxhetore të parashikuara janë 250,000 €; Komuna e Suharekës për vitin 2021 financon projektin me 48,200 €;

**Neni 3**
**Obligimet e MI-së**

1. MI-ja i siguron mjetet për projektet nga paragrafi 2 i këtij Memorandumi dhe nga një kopje i dërgon Komunës.

2. Ç'do tejkalim i vlerës së planifikuar për projektet nga paragrafi 2 i këtij Memorandumi do të mbulohet nga Komuna.

3. Pagesat për financim të projekteve nga MI-ja do të bëhen në pajtim me realizimin e punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës. Pagesat bëhen nga MI-ja deri në vlerën e financimit.

4. MI-ja cakton një zyrtar për mbikqyrjen e realizimit të projekteve nga fillimi deri në përfundim të kontratës. MI-ja me vendim do të caktoj detyrat, përgjrgjësitë dhe autozizimet e zyrtarit për mbikqyrje.

**Neni 4**
**Obligimet e Komunës**

1. Komuna siguron deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së projektit dhe një kopje e dërgon në MI.

2. Komuna obligohet ti krijoj kushtet e nevojshme për realizimin e projekteve për operatoret ekonomik, të ndërmerr te gjitha masat që kontraktuesi pa pengesë të filloj në implementimin e projekteve me kohë si dhe të siguroj specifikacionet teknike.

3. Komuna obligohet që projektet të zhvilloj në pajtim me Ligjin mbi prokurimin publik dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive si dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtyre ligjeve.

4. Komuna e kryen procesin e tenderimit dhe cakton komisionin për hapjen e ofertave dhe vlerësim të tenderit.

5. Komuna emëron projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projekteve, si dhe komisionin për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik, në të cilin komision duhet të jetë një anëtar nga MI-ja.

6. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagesen e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

7. Komuna obligohet që të njofton MI-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projekteve dhe për këtë të kërkojë pëlqimin nga MI-ja.

> 7.1. Komuna obligohet që në vend punishte të vendose tabelën informues (Pano) me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik.

8. Komuna obligohet që për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera në nivel të financimit nga MI-ja të kompletoj këto dokumente:

8.1. Procesverbalin e hapjes së tenderit dhe raportin e vlerësimit të tenderit (si dhe në rastet e korrigjimit të çmimeve të dorëzohen dokumentet e korrigjuara);

8.2. Kopjen e Kontratës të nënshkruar me operatorin ekonomik, së bashku me ofertën financiare, të vertetuara në bazë të origjinalit nga menaxheri i prokurimit të Komunës;

8.3. Vendimi mbi emërimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës dhe komisionin e pranimit nga ana e Komunës;

8.4. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimit mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet e aprovuara);

8.5. Faturën origjinale nga operatori ekonomik deri në lartësinë e shumës së financuar nga MI-ja dhe

8.6. Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave dhe Transfereve ).

9. Komuna duhet të ndërmarr të gjitha masat që projektet të përfundoj në përputhje me ndarjet buxhetore sipas viteve për projektin e tillë. Pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të Komunës.

10. Komuna është e obliguar të njoftoj MI-në për rrjedhat e realizimit të projektit sipas një plani dy javor deri në përfundim të projektit.

11. Komuna obligohet të ndërmarrë dhe kryej çdo lloj shpronësimi të nevojshëm për zbatimin e projekteve përfshirë procedurat dhe kompenzimin.

**Neni 6**
**Ndryshimet dhe ndërprerja e Memorandumit të Mirëkuptimit**

1. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MI-së dhe Kryetarit të Komunës, ky Memorandum mund të ndryshohet dhe plotësohet.

2. MI-ja mbanë të drejtën e ndërprerjës së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga ky Memorandum.

**Neni 7**
**Zgjidhja e kontesteve**

Palët janë pajtuar në mes veti që ky Memorandum të zgjidhet me mirëkuptim.

**Neni 8**
**Numri i Kopjeve**

Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruar në katër (4) kopje, nga dy (2) kopje për secilën palë nënshkruese.

**Neni 9**
**Pronësia e Projektit**

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga operatori ekonomik, ky investim (projekt) do të kaloje në pronësi të Komunës.

2. Ky investim regjistrohet në pronësi të Komunës në mënyrë elektronike dhe fizike në sistemin e pasurisë në Ministrin e Financave dhe Transfereve (SMIFK).

**Neni 10**
**Hyrja ne fuqi**

Palët nënshkruese janë pajtuar që ky Memorandum i Mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

| | |
|---|---|
| Ministri i MI-së | Kryetari Komunës |
| Arban ABRASHI | Bali MUHARREMAJ |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.**016-15642
**Me date: 05.03.2021**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik/Nr. A01, nxjerrë:

## VENDIM

11. Caktohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës "Furnizim me pako ushqimore " me numër të prokurimit: 624-20-8171-1-3-6.

12. Enver Shabani , Drejtor i Drejtoris për Shërbime Publike , Mjedis dhe Emergjencë , caktohet menaxher i kontratës.

13. Besa Kuci , Drejtoresh ne Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale , caktohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, sipas pikës 1 te këtij vendimi caktohet;

14. Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratë;

15. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Kryetari i Komunës**
**Bali MUHARREMAJ**

**Kopje:**
Menaxherit të projektit;
Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës;
Zyrës së Prokurimit;
Arkivit të Komunës-së

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA E SUHAREKËS**
**MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA**

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.** 016-15641
**Me date: 05.03.2021**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik/Nr. A01, nxjerrë:

**V E N D I M**

6. Caktohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës "Shërbime shëndetësore për P.A.K" me numër të prokurimit: 624-21-193-2-2-1, dhe numri i brendshëm i prokurimit:624-021-001-221 .

7. Sale Bytyqi , Drejtoreshë në QKMF-ë , caktohet menaxher i kontratës.

8. Besa Kuci, Drejtoreshë ne Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale , caktohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, sipas pikës 1 te këtij vendimi caktohet;

9. Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratë;

10. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Kryetari i Komunës**
**Bali MUHARREMAJ**

**Kopje:**
Menaxherit të projektit;
Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës;
Zyrës së Prokurimit;
Arkivit të Komunës-së

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA E SUHAREKËS**
**MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA**

---

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.** 410 - 17737
**Me date: 16.03.2021**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik/Nr. A01, nxjerrë:

## VENDIM

16. Caktohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës "Rregullimi I infrasktrukturës për Qerdhën e fëmijeve në Studenqan " me numër të prokurimit: **624-20-6981-5-2-1 & 624-20-140-5-2-1.**

17. Doruntina Bytyqi , Ingjiniere ne Drejtorin e Urbanzimit, caktohet menaxher i kontratës.

18. Remzi Bajselmani , Drejtor i Drejtoris së Arsimit , caktohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, sipas pikës 1 te këtij vendimi caktohet;

19. Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratë;

20. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Kryetari i Komunës**
**Bali MUHARREMAJ**

**Kopje:**
Menaxherit të projektit;
Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës;
Zyrës së Prokurimit;
Arkivit të Komunës-së

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.** 410 – 17737
**Me date: 16.03.2021**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik/Nr. A01, nxjerrë:

**VENDIM**

I. Caktohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës "Rregullimi I rrugës Brigada 123 Qender-Suharekë-Sheshi Suharekë, punë shtesë" me numër të prokurimit: **624-21-727-5-2-5.**

II. **Berat Kabashi**, Zyrtar për menaxhimin e projekteve, Ingjiniere ne Drejtorin e Urbanzimit, caktohet menaxher i kontratës.

III. **Doruntina Bytyçi**, Zyrtare në DUP, caktohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, sipas pikës 1 te këtij vendimi caktohet;

IV. Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratë;

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Kryetari i Komunës**
**Bali MUHARREMAJ**

**Kopje:**
Menaxherit të projektit;
Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës;
Zyrës së Prokurimit:
Arkivit të Komunës-së

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.** 410 - 17737
**Me date: 16.03.2021**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik/Nr. A01, nxjerrë:

## VENDIM

I. Caktohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës "Rregullimi I rrugës Brigada 123 Qender-Suharekë-Sheshi Suharekë, punë shtesë" me numër të prokurimit: **624-21-727-5-2-5.**

II. **Berat Kabashi**, Zyrtar për menaxhimin e projekteve në DSHPME, caktohet menaxher i kontratës.

III. **Doruntina Bytyçi**, Zyrtare në DUP, caktohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, sipas pikës 1 te këtij vendimi caktohet;

IV. Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratë;

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Kryetari i Komunës**
**Bali MUHARREMAJ**

**Kopje:**
Menaxherit të projektit;
Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës;
Zyrës së Prokurimit;
Arkivit të Komunës-së

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.** 016 – 18848
**Me date: 18.03.2021**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekë0 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

**Besa Kuqi, Drejtoresh e DSHMS** caktohet **Menaxher** i "Marrëveshjes së Mirëkuptimit për financim" në mes të Komunës së Suharekës dhe Priftit të Bashkësisë Katolike, për kryerjen e riteve fetare dhe mbulimi I shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Suharekës, përkatësisë fetare Katolike.

I. Menaxheri obligohet të hartoj një plan të dakorduar midis palëve të marreveshjes dhe i cili duhet të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të marrëveshjes.

II. Plani ka për qëllim menaxhimin e kësaj Marreveshje, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të marrëveshjes.

III. Plani i Menaxhimit të Marreveshjes është dokument i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në Marreveshje origjinale.

IV. Menaxheri i marreveshjes e menaxhon marreveshjen deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e saj.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Bali MUHARREMAJ

Kryetar i Komunës

Dergohet:
-Menaxherit të projektit,
- Arkivi

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.** 016 -18848
**Me date: 18.03.2021**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekë0 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, nxjerrë këtë:

# V E N D I M

**Besa Kuqi, Drejtoresh e DSHMS** caktohet **Menaxher** i "Marrëveshjes së Mirëkuptimit për financim" në mes të Komunës së Suharekës dhe Priftit të Bashkësisë Katolike, për kryerjen e riteve fetare dhe mbulimi I shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Suharekës, përkatësisë fetare Katolike.

I. Menaxheri obligohet të hartoj një plan të dakorduar midis palëve të marreveshjes dhe i cili duhet të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të marrëveshjes.

II. Plani ka për qëllim menaxhimin e kësaj Marreveshje, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të marrëveshjes.

III. Plani i Menaxhimit të Marreveshjes është dokument i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në Marreveshje origjinale.

IV. Menaxheri i marreveshjes e menaxhon marreveshjen deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e saj.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Bali MUHARREMAJ

Kryetar i Komunës

Dergohet:
-Menaxherit të projektit,
- Arkivi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.** 016 – 18939
**Me date: 23.03.2021**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik/Nr. A01, nxjerrë:

## VENDIM

**I.** Caktohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës "Shërbimet e parkingut për automjetet e zyrtarve komunal" me numër të prokurimit: **624-21-932-2-3-5.**

**II.** **Besart Gashi**, Zyrtar në DA, caktohet menaxher i kontratës.

**III.** **Donjeta Kololli**, Zyrtare në DA, caktohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, sipas pikës 1 te këtij vendimi caktohet;

**IV.** Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratë;

**V.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Kryetari i Komunës**
**Bali MUHARREMAJ**

**Kopje:**
Menaxherit të projektit;
Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës;
Zyrës së Prokurimit;
Arkivit të Komunës-së

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.**016-18844
**Me date: 18.03.2021**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekë0 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

**Besa Kuqi, Drejtoresh e DSHMS** caktohet **Menaxher** i "Marrëveshjes së Mirëkuptimit për financim" në mes të Komunës së Suharekës dhe Bashkësisë Islame në Suharekë, për kryerjen e riteve fetare dhe mbulimi I shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Suharekës, përkatësisë fetare Islame.

I. Menaxheri obligohet të hartoj një plan të dakorduar midis palëve të marreveshjes dhe i cili duhet të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të marrëveshjes.

II. Plani ka për qëllim menaxhimin e kësaj Marreveshje, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të marrëveshjes.

III. Plani i Menaxhimit të Marreveshjes është dokument i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në Marreveshje origjinale.

IV. Menaxheri i marreveshjes e menaxhon marreveshjen deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e saj.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Bali MUHARREMAJ

Kryetar i Komunës

Dergohet:
-Menaxherit të projektit,
- Arkivi

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.** 016-18844
**Me date: 18.03.2021**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekë0 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, nxjerrë këtë:

# V E N D I M

**Besa Kuqi, Drejtoresh e DSHMS** caktohet **Menaxher** i "Marrëveshjes së Mirëkuptimit për financim" në mes të Komunës së Suharekës dhe Bashkësisë Islame në Suharekë, për kryerjen e riteve fetare dhe mbulimi I shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Suharekës, përkatësisë fetare Islame.

I. Menaxheri obligohet të hartoj një plan të dakorduar midis palëve të marreveshjes dhe i cili duhet të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të marrëveshjes.

II. Plani ka për qëllim menaxhimin e kësaj Marreveshje, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të marrëveshjes.

III. Plani i Menaxhimit të Marreveshjes është dokument i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në Marreveshje origjinale.

IV. Menaxheri i marreveshjes e menaxhon marreveshjen deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e saj.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Bali MUHARREMAJ

Kryetar i Komunës

Dergohet:
-Menaxherit të projektit,
- Arkivi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.** 016 - 18939
**Me date: 23.03.2021**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik/Nr. A01, nxjerrë:

## VENDIM

I. Caktohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës "Shërbimet e parkingut për automjetet e zyrtarve komunal" me numër të prokurimit: **624-21-932-2-3-5.**

II. **Besart Gashi**, Zyrtar në DA, caktohet menaxher i kontratës.

III. **Donjeta Kololli**, Zyrtare në DA, caktohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, sipas pikës 1 te këtij vendimi caktohet;

IV. Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratë;

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Kryetari i Komunës**
**Bali MUHARREMAJ**

**Kopje:**
Menaxherit të projektit;
Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës;
Zyrës së Prokurimit;
Arkivit të Komunës-së

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT
MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE
MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
01 673
2 15.03.21
PRISHTINË NO.1

12.03.2021
REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA
REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA
PRIMLJENO RECEIVED
01 016 17338 7

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit*
*Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine*
*Ministry of Economy and Environment*

---

**ANEKS**

**MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT**

**Në mes**

**Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit**

**Dhe**

**Komunës së Suharekës**

**Për financim të projektit kapital**

"Ndërtimi i rezervuarit te ujit te Pusi i Atit ", KP: 18884 dhe
"Rregullimi i shtratit të lumit Toplluha - Suharekë", KP: 15795

**PRISHTINË 2021**

Në mbështetje të nenit 10 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7/1 Mars 2019, duke u bazuar në nënin 8 të Rregullores (QKR), Nr. 06/2020 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregullorën (QKR) Nr.m 07/2020 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës (QKR) Nr 06/2020, në nenin 5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), si dhe Ligjin nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 (Gazeta Zyrtare Nr.1, 06 Janar 2021), palët nënshkruese lidhin këtë:

Aneks Memorandumi i Mirëkuptimit, është vazhdim i bashkëfinancimit të projektit "Ndërtimi i rezervuarit te ujit te Pusi i Atit ", KP: 18884 dhe Projekti: "Rregullimi i shtratit të lumit Toplluha - Suharekë", KP: 15795.
Bazuar në Marrëveshjet e mirëkuptimit për finanicm me Nr. Prot. Nr.01/49 dhe Nr.01/50 dt.13.01.2021, ndërmjet Ministrisë dhe Komunës së Suharekës.

## Neni 1

Projekti Kapital : "Ndërtimi i rezervuarit te ujit te Pusi i Atit ", KP: 18884 financohet në vlerë prej: 400,000 (Katërqind mijë) Euro, ndërsa Projekti: "Rregullimi i shtratit të lumit Toplluha - Suharekë", KP: 15795 financohet në vlerë prej: 250,000 (Dyqindepesëdhjetë mijë) Euro.
Marrëveshja Nr. Nr.01/49 dhe Nr.01/50 dt.13.01.2021, pjesa e financimit, ndryshohet në përputhje me vlerën e financimit në Tab. 3.2, pas zbatimit të Nenit 9 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

**Muharrem Nitaj**
**Minister i MEA**

PRISHTINE

**Bali Muharremaj**
**Kryetar i Komunës së Suharekës**